

Emër Mbiemër: **AURELA ANASTAS**

Datëlindje: **07.04.1965**

Vendlindje: **Vlorë**

Viti i zgjedhjes: **2010 (akademike e asociuar)**
2017 (akademike)

Seksioni: **Shkencat shoqërore dhe albanologjike**

Gjuhët: **Anglisht, Frëngjisht, Italisht**



Kontakt

Adresa: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Rruga "Milto Tutulani", Tiranë

Telefon: +355 4 2241914

E-mail: avokatore2@yahoo.com

Faqe zyrtare: www.fd-ut.edu.al ; www.akad.gov.al

CV e shkurtër

Pedagoge dhe studiuese në fushën e së drejtës (nga viti 1987); avokate për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (nga viti 1996); mban titullin “Profesor” (2005); titullin “Akademike e asociuar” (2009) dhe “Akademike” (2017). Studimet e larta i kreu në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (1983–1987), pas përfundimit të të cilave u emërua aty si asistente pedagoge. Gjatë gjithë veprimtarisë së saj, ka punuar dhe ka kontribuar pranë departamentit të së drejtës publike të këtij fakulteti për mësimdhënien dhe zhvillimin e disiplineve shkencore të së drejtës kushtetuese dhe të historisë të së drejtës. Është themeluese e lëndës “barazia gjinore dhe ligji” dhe e disa disiplineve të tjera mësimore që zhvillohen në programet "master" dhe "doktoratë". Ka realizuar disa punime kërkimore e përgjithësuese në të drejtën kushtetuese; është autore/bashkautore e disa monografive dhe teksteve themelore; ka realizuar mjaft artikuj studimorë, referate e kumtesa në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit; është anëtare e redaksive botuese në disa revista shkencore; ka drejtuar e ka koordinuar disa projekte shkencore kombëtare e ndërkombëtare për zhvillimin e legjislacionit dhe të jurisprudencës. Ka trajtuar tema mjaft të rëndësishme për zhvillimin e doktrinës, të historisë dhe të legjislacionit në këto fusha të së drejtës. Në punimet e saj spikasin veçanërisht çështje thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të të drejtave të grave dhe të shtresave në nevojë; zhvillimin e institucioneve të shtetit të së drejtës dhe të drejtësisë kushtetuese në Shqipëri; përmirësimin e legjislacionit në lëmin kushtetues, të barazisë gjinore dhe të mosdiskriminimit; rregullimin e marrëdhënieve midis institucioneve, si dhe të raporteve midis fesë dhe shtetit; fuqizimin e ndihmesës së sektorit jofitimprurës në shoqërinë civile shqiptare etj. Ajo ka kontribuar në zhvillimin e metodave të kërkimit shkencor, ndër të cilat ka spikatur harmonizimi i metodës së krahasuar me atë historike të studimit të së drejtës. Përmes tyre ajo ka nxjerrë në pah mësimet e nevojshme për zhvillimin e

institucioneve dhe të së drejtës shqiptare në raport me standardet më të përparuara të së drejtës ndërkombëtare dhe të shteteve të tjera. Në studimet me karakter historik ka aktualizuar dobishmërinë e tyre në lidhje me zbatimet në praktikë të legjislacionit të ri shqiptar dhe të jurisprudencës gjyqësore. Në këtë të fundit, ka dhënë një ndihmesë të veçantë edhe përmes përfaqësimit si avokate në raste gjyqësore strategjike për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe përmes analizës së vendimeve gjyqësore. Ka qenë anëtare në disa komisione dhe ka drejtuar disa grupe pune në kuadrin e reformave kushtetuese e ligjore kombëtare. Ka spikatur në nismën, hartimin dhe lobimin e paketës së ligjeve të barazisë gjinore në shoqëri, për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ka qenë ndër hartueset e marrëveshjeve të komuniteteve fetare me Këshillin e Ministrave. Ndhimesë të veçantë ka ofruar për studentët dhe për studiuesit e rinj, përmes drejtimeve dhe kritikës shkencore. Ka përgatitur e ka përshtatur disa punime në ndihmë të studentëve dhe ka udhëhequr mjaft punime të diplomave universitare e pasuniversitare, si dhe të doktoratës. Ajo është nismëtare dhe drejtuese e disa aktiviteteve shkencore për të rinjtë juristë dhe e krijimit të organizatave *pro bono* të studentëve të fakultetit të drejtësisë, me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore falas për shtresat në nevojë. Gjatë kësaj periudhe Aurela Anastas ka kryer edhe disa detyra të rëndësishme shtetërore e shoqërore. Ajo është zgjedhur për dy mandate rresht përgjegjëse e departamentit të së drejtës publike në Fakultetin e Drejtësisë, UT, ndërsa në periudha afatshkurtra është emëruar zëvendësdekane e dekane e këtij fakulteti. Është pedagoge e jashtme dhe eksperte në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pranë Shkollës së Magjistraturës si dhe e avokatëve, pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë. Është aktiviste e shquar e shoqërisë civile, anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Konstitucionalistëve si dhe anëtare e Komisionit Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisionit të Venecias).

Publikime (monografi, vepra kolektive, përmbledhje studimesh)

2014, 2016

E drejta Kushtetuese (ribotime të përmirësuara për të pasqyruar ndryshimet e reja kushtetuese).

2012

Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi. (Miratuar nga departamenti i së drejtës publike, Fakulteti i Drejtësisë, UT), botim i UN Women; Ambasada Spanjolle në Tiranë, Tiranë, ISBN: 978-9928-162-04-5. (Bashkautore)

2012.

Të drejtat kushtetuese në interpretimin e Gjykatës së Lartë të SHBA^{-së} (vendime të përzgjedhura). (Bashkautore), Sh.B. "Dajti 2000", Tiranë, 245 f., Tiranë, ISBN: 978-99956-59-19-6.

2011.

Shteti i së drejtës në kushtetutën e RSH-së (monografi). Botim i Universitetit të Tiranës dhe fondacionit "Konrad Adenauer Stiftung", shtëpia botuese "Adelprint", Tiranë, 296 f., ISBN: 978-99956-32-09-0. (bashkautore me: Xhezair Zaganjori; Eralda Methasani)

2010

E drejta kushtetuese. shtëpia botuese "ABC", Tiranë, (ribotohet për herë të dytë me përmirësime), 476 f., ISBN: 978-99956-01-41-6. (Bashkautorë: Aurela Anastasi, Luan Omari)

2010

Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare e ndërkombëtare (Udhëzues). Botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë, ISBN: 978-99956-58-18-2. (Bashkautore)

2009

E drejta kushtetuese e krahasuar (vendime të përzgjedhura dhe komente). Sh.B. "Dajti 2000", Tiranë, ISBN: 978-99956-606-7-3.

2008

Njohuri bazë për të drejtën kushtetuese dhe administrative (cikël Leksionesh për studentët e Fakultetit të Ekonomisë). Tiranë, ISBN: 99956-03-15-2. (Bashkautore)

2007

Historia e së drejtës kushtetuese në Shqipëri (1912–1939). Tiranë, shtëpia botuese "Pegi", 212 f., ISBN: 978-99943-40-46-0.

2004

E drejta kushtetuese. Tiranë, Shtëpia botuese "Pegi", 253 f., ISBN: 99927-941-1-9.

1998

Historia e institucioneve (tekst mësimor për studentët e drejtësisë). Tiranë, SHBLU, 487 f. ISBN: 99927-0-297-4.

1998

Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri (1912–1939) (monografi). Tiranë, shtëpia botuese "Luarasi", 290 f. ISBN: 99927-606-2-1.